

VENDIM
Nr. 877, datë 11.11.2020

**PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË
MARRËVESHJES SË HUAS (DATË 30 QERSHOR 2008, MARRËVESHJE HUAJE
NR. ABA-P3) NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (TË
ZËVENDËSUAR NGA AGJENCIA JAPONEZE E BASHKËPUNIMIT
NDËRKOMBËTAR NË TETOR 2008), PËR PROJEKTIN “PËRMIRËSIMI I
SISTEMIT TË KANALIZIMEVE PËR TIRANËN E MADHE”, RATIFIKUAR ME
LIGJIN NR. 9964, DATË 24.7.2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas (datë 30 qershor 2008, marrëveshje huaje nr. ABA-P3) ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (të zëvendësuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në tetor 2008), për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Agjencia për Bashkëpunim Ndërkombëtar Japonez
Datë 8 nëntor 2019
Ref. nr. JICA (7R) 11-07001

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Republika e Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri

Drejtuar: Sh.S. znj. Anila Demaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë, Republika e Shqipërisë

Marrëveshja e Huas nr. ABA-P3, datë 30 qershor 2008, për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve në Tiranën e Madhe”.

Në referencë të letrës suaj nr. 17272/1, të datës 9 tetor 2019, dhe të notës verbale nr. 078/2019, datë 24 tetor 2019, të Ambasadës së Japonisë në Republikën e Shqipërisë, drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila shpreh pëlqimin e Qeverisë Japoneze për kërkesën e Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e periudhës së disbursimit të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huas, me anë të kësaj biem dakord si më poshtë:

1. Seksioni 2(2) i nenit I, që të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huas, ndryshohet si më poshtë:

“Disbursimi përfundimtar sipas Marrëveshjes së Huas do të kryhet jo më vonë se data 24 prill 2022 dhe pas kësaj date nga ana e JICA-së nuk do të kryhet asnjë disbursim i mëtejshëm, përveçse kur bihet dakord ndërmjet JICA-së dhe Huamarrësit.”.

2. Ky ndryshim hyn në fuqi nga data kur JICA njoftohet se kanë përfunduar procedurat e nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huas së lartpërmendur në Republikën e Shqipërisë.

3. Kjo letër nuk do të interpretohet për të autorizuar ndonjë ndryshim tjetër përveç atij të përmendur më lart.

Në momentin që përfundojnë procedurat e nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huas në Republikën e Shqipërisë, ju lutem konfirmoni miratimin tuaj për amendimin e mësipërm, duke nënshkruar atë dhe kopjen bashkëlidhur kësaj shkrese, duke ruajtur një kopje tuajën dhe duke na kthyer kopjen tjetër.

Me respekt,

AGJENCIA PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR JAPONEZ

Nga: Nënshkrimi
Takema Sakamoto
Drejtor i Përgjithshëm
Departamenti i Lindjes së Mesme dhe Evropës

Konfirmuar:

Në datën 29.7.2020 _____

Për: MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nga: MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

Në vëmendje të: Përfaqësuesit Kryesor, Zyra Ballkanike JICA